K O N K L U Z I O N E T

E MBLEDHJES KONSULTATIVE TË LPRK-së

(*Të krijohet Fronti i Rezistencës për Çlirim*)

Kombi shqiptar aktualisht gjendet në fazën më të rëndë të historisë së tij. Përveç që ra nën okupim më të rëndë ai u nda midis shteteve të Ballkanit të dala nga ish-Jugosllavia. Këtë pushtim të ri e sanksionuan edhe organizmat ndërkombëtarë. Çka është më e keqja, partitë politike në vend që të marrin qëndrim të drejtë dhe të ndryshojnë mënyrën e veprimit të tyre, të vetëdijshëm, apo pa i menduar pasojat, u pajtuan me "zgjedhjet" e përcaktuara nga të huajt dhe si forma të veprimtarisë edhe më tutje i kanë përcaktuar format pacifiste, ato forma që çuan te pushtimi edhe më i egër. Nga ana tjetër kemi një lëvizje dhe pakënaqësi të madhe të masave me gjendjen e krijuar, e cila me siguri do të intensifikohet në të ardhmen për të arritur në mënyrë të pashmangshme deri te përleshja e armatosur me armikun. Nga kjo situatë e krijuar dalin detyra konkrete para organizatës.
Mbi këtë bazë nga Mbledhja Konsultative dalin këto konkluzione:

I

Të përgatiten dhe të zhvillohen veprimtari për të çliruar vendin tonë të pushtuar, duke filluar me aksione popullore: demonstrata, greva, protesta, aksione konkrete në përputhshmëri me format qytetare të rezistencës, të shtrirë në gjithë hapësirën shqiptare. Ato duhet të jenë të organizuara, të kohës dhe të kryhen me diciplinë të rreptë.

II

Kur dihet se LPRK-ja në Kosovë dhe jashtë vendit ruan në vete përvojën e aksioneve kombëtare kundër pushtuesve, dhe se anëtarët e saj janë të gatshëm që të punojnë e luftojnë deri në çlirimin e vendit, del si detyrë forcimi organizativ i LPRK-së. Kjo nuk duhet parë ngushtë, vetëm si çështje e forcimit të një subjekti politik, por duhet kuptuar si detyrë që çon drejtë forcimit të rezistencës aktive gjithëpopullore dhe krijimit të frontit çlirimtar. Kjo shtron si detyrë para çdo anëtari që të veprojë me përpikmëri sipas Programit, Statutit dhe vendimeve të organizatës. Të rritet diciplina, gatishmëria, vigjilenca dhe fryma e veprimit konkret, në mënyrë që kështu të kontribuojmë së bashku në këtë çështje të madhe kombëtare.

III

Mbi bazën juridike të vendimit të organizatës shumë veprimtarë të LPRK-së vepruan në subjektet tjera legale. Këta anëtarë, për një kohë e luajtën rolin e vet në këto subjekte. Tash e mbrapa vetëm aktiviteti përmes organizimit legal nuk mjafton për realizimin e pikësynimeve kombëtare.

IV

Të forcohet propaganda në Kosovë. Të shpërndahet "Zëri i Kosovës". Aty ku nuk mbërrin, të shumëzohet dhe të shpërndahen artikujt më sqarues të "Zërit të Kosovës". Të përgatitet një buletin, si organ informativ politik, ndërkaq me anëtarët të komunikohet me komunikata, qarkore etj. Njëherit kërkohet kudo që gjendet anëtari i LPRK-së, pa e identifikuar veten të propagandojë vijën politike të Organizatës.

V

Bashkpunimi i LPRK-së me subjektet politike e shtetërore në Kosovë do të jetë e mundur vetëm me veprime konkrete kundër pushtuesve. Duke u nisur nga fakti që partitë legale në Kosovë ndjekin një politikë kapitulluese, del qartë se barra e veprimtarisë çlirimtare do t'u bjerë LPRK-së dhe subjekteve që janë të vendosur të vazhdojnë luftën deri në fitoren përfundimtare.

VI

Duke pasur parasyshë se në Parlamentin dhe Qeverinë maqedonase, në qeveritë lokale malazeze e serbe të Kosovës lindore hynë dhe po punojnë me zell disa subjekte politike shqiptare, me këtë rast shkelin mbi përcaktimet politiko-kombëtare dhe me të drejtë të bashkimit me Republikën e Kosovës, nga janë ndarë me dhunë. Meqenëse këto subjekte shqiptare nga këto vise të Kosovës e kanë pranuar pushtetin serbo-malazez, përkatësisht maqedon, LPRK-ja shkëput kontaktet me udhëheqjet e këtyre subjekteve, dhe thërret degët e nëndegët si dhe të gjithë antarët e këtyre subjekteve t'i bëjnë presion udhëheqjeve të këtyre partive politike të përfaqësuara në parlament dhe në qeveri, që t'u përmbahen programeve të tyre dhe ta zbatojnë vullnetin politik të popullit.

VII

Duke pasur parasysh që herë pas here ka pasur tendenca që të përqëndrohet vëmendja e kombit tonë në probleme të brendshme, dhe

sidomos të konfrontohen pjesët e ndara të kombit në realcion me shtetin amë dhe trojet jashtë tij, LPRK do t'i kushtojë vëmendje të posaçme që aktiviteti, lufta dhe puna e jonë të orientohet në frontin kundër pushtuesve serbo-maqedono-malazez. Qëndrimi i LPRK-së ndaj shtetit amë nuk varet nga forca politike që është në pushtet. Asaj i intereson Shqipëria e pavarur dhe përkrahja sa më e madhe për çlirimin e Kosovës.

VIII

Çështja kombëtare do të gjejë përkrahje në faktorin e jashtëm vetëm atëherë kur faktori i brendshëm është i organizuar dhe i vendosur për ta çuar çështjen përpara duke aplikuar të gjitha mjetet e luftës çlirimtare. Kjo mungesë në kuadër të kombit tonë bëri që organizmat ndërkombëtarë qoftë për shkak të interesave të tyre ekonomike, qoftë për shkak të raportit të forcave, të aprovojnë qëndrimin mbi aneksimin e viseve tona shteteve të Ballkanit. Përkundër asaj që rebulikat u ndanë në shtete të pavarura, përkundër asaj që lufta për mbizotërim filloi, përkundër asaj që dhuna ndaj shqiptarëve vazhdon me përmasa edhe më të mëdha, çështja shqiptare mbeti pa zënë vend me rëndësi në konferencat ndërkombëtare. As BE, as NATO, as KSBE, as OKB, as ndonjë organizëm tjetër nuk do ta zgjidhi çështjen tonë, nëse kombi nuk bëhet zot i fatit të vet. Këto organizma veprojnë sipas pikësynimeve të tyre dhe të mbështetura në to i përcaktojnë zgjedhjet.

Kosovë, prill 1993

LËVIZJA POPULLORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS